



Datë: 18.12.2025
Numër Protokolli: 276/2026

A.nr.1965/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, si dhe Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.1965/2025, të datës 01.12.2025, të parashtruar nga ankuesja G.K-V, kundër organit të punësimit/Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “kontest nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.1965/2025, e datës 01.12.2025, e parashtruara nga ankuesja G.K-V, ashtu që, detyrohet Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi të shqyrtoj kërkesën e ankueses të datës 01.10.2025 dhe të nxjerr akt administrativ në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile G.K-V, (tutje referuar vetëm ankuesja), më datë 01.12.2025, përmes postes elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.1965/2025, kundër Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, për shkak të mos njohjes së përvojës së punës si dhe kompensimin retroaktiv.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 03.12.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses të Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa, kjo e fundit më datë 11.12.2025 ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesja sipas Akt Emërimit me numër të protokollit 1217/2024, të datës 11.04.2024, është e punësuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve në pozitën Zyrtare e Lartë e Skemave Pensionale/ Zyra e Pensioneve në Mitrovicë.

Tutje, sipas shkresave të lëndës del se ankuesja më datë 21.08.2025, i është drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, me kërkesë për rishikim dhe përditësim të përvojës së punës në SIMBNJ, duke specifikuar së mungojnë rreth pesë (5) vite përvojë pune të pa pasqyruar në mënyrë të plotë, mungojnë rreth dhjetë (10) ditë pushimi vjetor nga përvoja e përgjithshme, dhe si pasojë e kësaj është reflektuar një llogaritje jo e saktë e përvojës e cila ndikon drejtpërdrejtë edhe në vlerësimin e rrogës si dhe liston përvojën e punës ndër vite si në vijim: Zyrtare e Prokurimit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural prej datës 03.05.2011-02.05.2016; Eksperte e Reformës në Ministria e Administratës Publike nga data 01.06.2017-31.08.2017, 01.09.2017-30.11.2017, 01.12.2027-28.02.2018; Zyrtare për Raportim dhe Mbështetje në Ministrinë e Administratës Publike nga data 07.05.2018-06.05.2019; Zyrtare për Raportim dhe Mbështetje në Ministrinë e Punëve nga data 06.05.2019-02.02.2020 dhe 02.02.2020-06.08.2023; Zyrtare e Lartë e Skemave Pensionale 07.08.2023 dhe vazhdon. Ndërsa, me datë 01.10.2025 ka përsëritur të njëjtën kërkesë.

Ankuesja, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin se nga 14 vite përvojë pune, ndërsa, në listën e pagave figurojnë vetëm 8 vite duke u dëmtuar 300-400 euro, në pagë. Kërkon që Këshilli të vendos lidhur me ankesën e ankueses ashtu që të njëjtës t'i njihet përvoja e punës prej 14 vitesh si dhe ti behët kompensimi retroaktiv lidhur me këtë mos njohje.

Kolegji i Këshillit ndërlidhur me rregullat e veprimeve procedurale të një organi publik, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (*tutje referuar: LPPA*), përkatësisht nenit 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *2. Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative*, si dhe nenit 97 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: *1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative*, dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes, Kolegji i Këshillit konstatoi se organi përkatës i punësimit, në raport me kërkesën 01.10.2025, të parashtruar nga ankuesja, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat përkatëse ligjore, ngase sipas bazës ligjore si me sipër, vullneti i organit publik në realizimin e autoritetit publik formësohet në procedurë administrative dhe manifestohet në formën e njërit prej veprimeve administrative, siç janë: akti administrativ; kontrata administrative apo akti real, dhe se në vlerësimin e Kolegjit, organi përkatës i punësimit, në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, është dashur që të nxjerr akt administrativ në kuptim të vendosjes dhe të njoftoj palën për aktin e tillë, brenda një afati prej 45 ditësh sikurse përcaktohet me nenin 98 paragrafi 2 apo afatit të vazhduar sipas nenit 99 paragrafi 1 të LPPA-së.

Kështu që thënë si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi të aprovoj si të bazuar ankesën në kuptim të shkeljeve procedurale, dhe si rrjedhojë detyroj Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të shqyrtoj kërkesën e ankueses të datës 01.10.2025 dhe të nxjerr akt administrativ në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

KËSHILLË JURIDIKE: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.1965/2025

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses G.K-V;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MFPT, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.